



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:057075

Datë: 01.03.2021

Numri i dokumentit: 01552822

C.nr.101/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Jonuz Bugari**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditësve I. K. nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, H. B. - P. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, M. B. nga fshati Brestovc, Komuna e Rahovecit, S. K. nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, A. P. nga Rahoveci dhe A. O. nga Rahoveci, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati A. M. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B. O., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit e shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit, vlera e kontestit **10,162.00 €**, pas mbajtje përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, më **27.01.2021**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT APROVOHET padia dhe kërkesëpafia e paditësve I. K., H. B. - P., M. B., S. K., A. P. dhe A. O. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve e duke filluar prej datës 18.04.2017 e deri me datën 31.12.2020, t'u paguaj kompensim në emër të udhëtimit prej 70 % nga biletat kushtuese dhe kompensim në emër të ushqimit gjatë punës për në lartësi prej 2,00 €, për një ditë pune për secilin paditës si vijon:

- Paditësit të parë I. K., në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për 602 ditë, në relacion Hoçë e Vogël – Rahovec dhe anasjelltas dhe atë 70 % nga biletat kthyesë prej 1,40 €, në ditë, t'ia shumë prej 589,96 €, respektivisht shumë prej 133,04 Euro, e refuzoj si të pa bazë, si dhe në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 602 ditë, në vlerë prej 2,00 €, për një ditë pune, shumë prej 1,204.00 €, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 1,793.96 €.
- Paditëses së dytë H. B. - P., në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për 597 ditë, në relacion Krushë e Madhe – Rahovec dhe anasjelltas dhe atë 70 % nga biletat kthyesë prej 2,60 €, në ditë, t'ia shumë prej 1,087.00 €, si dhe në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 597 ditë, në vlerë prej 2,00 €, për një ditë pune, shumë prej 1,194.00 €, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 2,278.00 €.
- Paditësit të tretë M. B., në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për 595 ditë, në relacion Brestovc – Rahovec dhe anasjelltas dhe atë 70 % nga biletat kthyesë prej 1,40 €, në ditë, t'ia shumë prej 583,10 €, respektivisht shumë prej 30,90 Euro, e refuzoj si të pa bazë, si dhe në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 583 ditë, në vlerë prej 2,00 €, për një ditë pune, shumë prej 1,190.00 €, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 1,773.10 €.

- Paditëses së katërt S. K., në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për 355 ditë, në relacion Ratkoc – Rahovec dhe anasjelltas dhe atë 70 % nga biletat kthyesë prej 3,00 €, në ditë, t'ia shumë prej 745,90 €, respektivisht shumë prej 1,10 Euro, e refuzoj si të pa bazë, si dhe në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 355 ditë, në vlerë prej 2,00 €, për një ditë pune, shumë prej 710,00 €, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 1,455.90 €.
- Paditëses së Pestë A. P., në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 602 ditë, në vlerë prej 2,00 €, për një ditë pune, shumë prej 1,204.00 €.
- Paditëses së gjashtë A. O., në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për 357 ditë, në relacion Zoqishtë – Rahovec dhe anasjelltas dhe atë 70 % nga biletat kthyesë prej 1,40 €, në ditë, t'ia shumë prej 349,86 €, si dhe në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 357 ditë, në vlerë prej 2,00 €, për një ditë pune, shumë prej 714,00 €, respektivisht shumë prej 342,00 Euro, e refuzoj si të pa bazë, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 1,063.86 €, apo gjithsej shumë prej **9,568.82 Euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi (27.01.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, **SI ME BAZË**.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 2,159.00 Euro me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit I. K., H. B. - P., M. B., S. K., A. P. dhe A. O., kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit.

E paditura me parashtrësën e saj përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve ndaj të paditurës.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i paditësve avokati A. M., si dhe përfaqësuesi i të paditurës B. O. jurist i diplomuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati A. M., deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë së ushtruar, kërkesëpadisë, pretendimeve në padi, si dhe pranë parashtrësës mbi precizimin e kërkeskëajdsë prej datës 21.01.2021. ritheksoi se këtu paditësit me kontratat të përhershme pune, janë në marrëdhënie pune pranë këtu të paditurës, përkatësisht pranë SHFMU "I. S." në Rahovec. Paditësve por të drejtave të tjera nga marrëdhëniet e punës, e sipas dispozitave të nenit 35.5 të kontratës kolektive të arsimit para universitar të vitit 2017, punonjësve arsimor që udhëtojnë në vend banimet e komunës ku punojnë, u takojnë edhe shpenzimet e udhëtimit dhe atë 70 % nga biletat e udhëtimit urban, e pos kësaj të drejtje, të punësuarëve u sigurohet edhe kompensimi për ushqim gjatë punës për dëtet e pranishëm në punë e që vlera e shpenzimit të ushqimit për një ditë pune është në lartësi prej 2 Euro, e në rastin konkret, e paditura paditësve nuk ua ka kompensuar as shpenzimet e udhëtimit e as shpenzimet e ushqimit, siç është cekur në padi dhe në parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadisë, prej datës 21.01.2021. Gjykatës i propozoi që të zbatoj procedurën e provave, të i procedojë të gjitha provat e propozuara, e në seancën e sotme i propozoi gjykatës që si provat të veqanta ta procedojë vërtetimin e lëshuar nga ana e Drejtorisë nga SHFMU "I. B." në Rahovec, numri i protokollit 101/21 prej datës 17.01.2021, ekstrakti gjendjes civile për

paditësen S. K., certifikata e vendbanimin për paditësen H. B. - P., për paditësin M. B., për paditësin I. K. dhe për paditësen A. O., Biletat e udhëtimit për paditësin I. K. si dhe përgjigjen në kërkesën e paditësve nga ana e Drejtoritë të Drejtoratit të Arsimit nr. 04/080, prej datës 23.01.2020, ku i njëjti ka pranuar kërkesën e palëve si të arsyeshme dhe DKA-ja, ka shprehur vullnetin që të i përmbushë detyrimet nga kontrata kolektive e vitit 2017. Paditësit nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar, këtu të paditurës i ka ushtruar kërkesë të veçantë nr. i protokollit 3893, prej datës 13.12.2019, që e paditura në mënyrë administrative të i përmbushë detyrimet ndaj paditësve, por e paditura edhe sot e kësaj dite nuk i ka kryer detyrimet e veta, andaj i propozoi gjykatës që të zbatojë procedurën e provave, të i procedoi të gjitha provat të proceduara në padi si dhe të gjitha provat të propozuara me precizimin e kërkesëpadisë, i kërkoi shpenzimet procedurale sipas tarifës sipas Odës së Avokatëve, në shumë prej 2,159.00 €, andaj në fund i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta miratojë në tërësi si me bazë.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B. O. deklaroi se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke qenë se e paditura konsideron që i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore. Njofton gjykatën se në këtë seancë, e dorëzuan përgjigjen në padi, me të cilën po ashtu kontestojnë kërkesëpadinë, rrjedhimisht mbesim pranë theksimeve në këtë përgjigje. Për më tepër, shtojmë se e paditura Komuna e Rahovecit, nuk e konteston qëllimin e dispozitave të Kontratës Kolektive, por kërkon nga gjykata që të vlerësojë sidomos dispozitat e nenit 46 të Kontratës Kolektive, me të cilën dispozitë nënshkruetit, respektivisht palët kanë marrë obligime që të sigurojnë mjetet financiare për të zbatuar dispozitat që kanë implikime financiare. Më tepër mbesim në tërësi pranë deklarimeve në përgjigjen në padi. Me këtë rast, gjykatës i ofrojnë provën, respektivisht vendimin e kryetarit të komunës për caktimin e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave nga Kontrata Kolektive e arsimit, e cila duhet të shërbej si shqyrtim i kërkesave pranë të paditurës në procedurë administrative. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se Kontrata Kolektive sipas Ligjit të Punës, mund të lidhet në nivel qendror, në nivel lokal dhe në nivel të ndërmarrjes punuese, duke qenë se kjo Kontratë Kolektive e Arsimit është e lidhur në mes të dy subjekteve të nivelit qendror, mendon që në këtë rast duhet të bëhet cedimi i kontratës tek personi i tretë, që në këtë rast është e paditura si Organizatë Buxhetore e nivelit lokal. Për këtë janë përcaktuar edhe veprimet që do të duhet t'i ndërmerren dy subjektet e kontratës, respektivisht Ministria e Arsimit, si organizatë buxhetore e nivelit qendror, për të siguruar mjetet financiare të cilat do të duhej t'i alokoheshin të paditurës për të zbatuar dispozitat ligjore që kanë implikime financiare. Në këtë drejtim, e paditura nuk konteston të drejtën e mësimdhënësve për shpërblime, por që thekson se dy palët nënshkruese të Kontratës Kolektive nuk kanë siguruar mjetet financiare për komunat e Republikës së Kosovës, respektivisht këtu të paditurës Komuna e Rahovecit. Andaj, i propozoi gjykatës që në mungesë të legjitimitetit pasiv, kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë tërësisht si të palejuar dhe të pabazë.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin nr.8515 të datës 01.09.2015, për paditësin I. K., ka bërë shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin nr. 8415 e datës 01.09.2015, për paditësen F. B. - P., ka bërë shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin nr. 9215 e datës 01.09.2015, për paditësin M. B., ka bërë shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin nr. 109/2015 e datës 01.09.2015, për paditësen S. K., ka bërë shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin nr. 60/2015 e datës 01.09.2015, për paditësen A. P., ka bërë shikimin në kontratën e punës për mësimdhënësin nr. 495-2 e datës 01.09.2016, për paditësen A. O., ka bërë shikimin në kërkesën e mësimdhënësve nr. 3893 të datës 13.12.2019, ka bërë shikimin në kopjen e biletave të udhëtimit të prezantuara nga ana e përfaqësuesit të paditësve, ka bërë shikimin në përgjigjen e Drejtorisë Komunale për Arsim nr. 04/080 e datës 23.01.2020, ka bërë

shikimin në provat të bashkangjitura precizimit të kërkesëpadisë të ushtruar më datë 21.01.2021, si dhe ka bërë shikimin në vendimin e të paditurës nr. 1537 e datës 24.11.2020.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, ka proceduar kontratën e punës për mësimdhënësin nr.8515 të datës 01.09.2015, për paditësin I. K., dhe se nga ky vërtetim, gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi I. K. i cili ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësimdhënës i Historisë dhe Gjeografisë në SHFMU “I. S.” në Rahovec.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës nr. 8415 e datës 01.09.2015, për paditësen F. B. - P., vërtetohet se paditësja F. B. - P. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësimdhënëse e Matematikës në SHFMU “I. S.” në Rahovec.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës nr. 9215 e datës 01.09.2015, për paditësin M. B., vërtetohet se paditësi M. B. ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësimdhënës i Kimisë në SHFMU “I. S.” në Rahovec.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës nr. 109/2015 e datës 01.09.2015, për paditësen S. K., vërtetohet se paditësja S. K. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësimdhënëse e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në SHFMU “I. S.” në Rahovec.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës nr. 60/2015 e datës 01.09.2015, për paditësen A. P., vërtetohet se paditësja A. P. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Mësuese klase në SHFMU “I. S.” në Rahovec.

Me shikimin në kontratën e punës për mësimdhënës nr. 495-2 e datës 01.09.2016, për paditësen A. O., vërtetohet se paditësja A. O. ka qenë e sistemuar në punët dhe detyrat e punës si Arsimitare në SHFMU “H. S.” në Zoqishtë.

Me shikimin në kërkesën e mësimdhënësve nr. 3893 të datës 13.12.2019, vërtetohet se kanë kërkuar pagimin e kompensimit për ushqim.

Me shikimin në kopjen e biletave të udhëtimit të prezantuara nga ana e përfaqësuesit të paditësve, vërtetohet se të njëjtin kanë paguar shuma për udhëtim.

Me shikimin në përgjigjen e Drejtorisë Komunale për Arsim nr. 04/080 e datës 23.01.2020, konstatohet se kërkesa është e arsyeshme dhe DKA ka vullnet të marrë të gjitha masa e nevojshme në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017.

Me shikimin në vendimin të paditurës nr.1537 e datës 24.11.2020, është caktuar komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë.

Sipas dispozitës së nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: **“ Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë**

pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet pjesërisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë pjesërisht si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t’ia paguajë pagat në emër të udhëtimit dhe ushqimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t’ia kompensoj paditësve shumën prej 2,159.00 Euro e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 624,00 €, në emër të parashtresës shumën prej 624,00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 100,00 €, për përfaqësim në një seancë shumën prej 811,00 Euro.

GJYKATA THEMELROE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, C.nr.101/2020, më 27.01.2021

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Jonuz Bugari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.